

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika ViscoBond® GR

AGJENT LIDHËS I GJENERATËS SË RE DHE ADITIV PËR LLAÇ DHE BETON



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika ViscoBond® GR është një aditiv i lëngshëm i përqëndruar për përdorim si një agjent lidhës me produktet me bazë çimentoje në aplikime të brendshme ose të jashtme. Përdoret gjithashtu si një modifikues i llaçeve dhe betonit për hidroizolim, përmirësimin e punueshmërisë dhe për zhvillimin e rezistencave ndaj tërheqjes, përkuljes dhe të lidhjes.

PËRDORIMET

4 në 1: Agjent lidhës – aditiv rezistues ndaj ujit – plastifikues – përmirësues i rezistencës

- Shtresë e sprucos lidhëse që aplikohet përpara suvatimit dhe shtresave izoluese
- Suvatime dhe veshje hidroizoluese me rritje të adezionit me më pak plasaritje (gjithashtu e përshtatshme për llaçe suvatimi me bazë gipsi ose gëlqereje)
- Shtresa izolimi dyshemeje me rezistencë të lartë / mbishtresa me më pak pluhur dhe rezistente ndaj konsumimit dhe ujit
- Llaç mbushës për fugat dhe fugat bosh të muraturës
- Llaç riparimi lokal, meremetimi dhe riprofilizimi

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Formulë e përqëndruar me performancë të lartë e fuqizuar nga teknologjia Sika® ViscoCrete®
- Forcë e shtuar e ngjitjes - ndërkapje e shkëlqyer edhe mbi nënshtresat e lëmuara
- Përshkueshmëri e ulur
- Punueshmëri e përmirësuar ndjeshëm
- Plasaritje e reduktuar
- Rezistencë e shtuar ndaj dëmtimit nga ngrica
- Rezistencë, elasticitet dhe papërshkueshmëri të përmirësuar
- Përmirëson rezistencën kimike të llaçit dhe betonit

MIRATIME / STANDARDE

- Aditiv rezistues ndaj ujit sipas EN 934-2:2009+A1:2012 (Tabela 9), Deklaratë Performance 18122705 dhe mbart markën CE.
- Aditiv ajër-futës / plastifikues sipas EN 934-03:2009+A1:2012 (Tabela 2), Deklaratë Performance 48628713 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Dispersion ujour butadien-stireni dhe polikarboksilatësh të modifikuara
Ambalazhi	shishe plastike 3.5L dhe 10L
Paraqitja / Ngjyra	Lëng ngjyrë blu e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.0 g/cm ³ (në +23°C)

Vlera e pH	5.5 ± 1
Receta e llaçit	<p>Spruco lidhëse për llaçet e dyshemesë Përbërës të thatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1 pjesë për vëllim çimentoje ▪ 1-2 pjesë për vëllim rëre <p>Tretësira e Sika ViscoBond® GR me ujë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1:2 deri në 1:4 për vëllim Sika ViscoBond® GR <p>Llaç Përbërës të thatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1 pjesë për vëllim çimentoje ▪ 2-4 pjesë për vëllim rëre <p>Tretësira e Sika ViscoBond® GR me ujë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1:2 deri në 1:7 për vëllim Sika ViscoBond® GR

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar	Në të gjitha rastet (shih Mortar Mix Design), përzieni përbërësit e thatë së bashku dhe më pas shtoni tretësirën e Sika ViscoBond® GR me ujë në sasinë e kërkuar, derisa të prodhohet një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.
Konsumimi	<p>Sika ViscoBond® GR mbulon një shumëllojshmëri të madhe aplikimesh. Konsumimi i tij varet nga parametra si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Lloji dhe sasia e çimentos ▪ Karakteristikat e agregateve ▪ Qëllimi i përdorimit të miksit të përdorur <p>Konsumimi i përafërt:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Si spruco e hollë lidhëse: 0.10 – 0.16 lt/ m²/ mm të trashësisë së shtresës (derisa të arrihet konsistenca e dëshiruar) - Si aditiv në llaç: 0.3 – 0.6 lt/ 10 lt llaçi (mund të përdoren përqindje të ndryshme tretësire pas testimeve paraprake) - Si aditiv në beton: deri në 10% të peshës së çimentos (duhet të kryhen testime përshtatshme përpara aplikimit)

UDHËZIME APLIKIMI

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Hapi 1: Shtoni produktin tek uji i përzierjes sipas raportit të specifikuar të hollimit për llojin e aplikimit.

Hapi 2: Përzieni përbërësit e thatë së bashku, shtoni tretësirën në sasinë e kërkuar ndërsa jeni duke përzierë për të paktën 90 sekonda, derisa të jetë prodhuar një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.

KUFIZIME

- Përdorimi i Sika ViscoBond® GR duhet bërë bazuar mbi një recetë të përshtatshme dhe burimet vendase të materialeve duhen testuar.
- Mos përdorni Sika ViscoBond® GR në temperatura nën 5°C.
- Sika ViscoBond® GR nuk duhet të shtohet në çimento të thatë.
- Sigurohuni gjithmonë se tretësira minimale e përzierjes përdoret gjatë fazave të hershme të përzierjes dhe shtoni më tepër në fund. Kjo do të ndihmojë në arritjen e konsistencës së kërkuar.
- Përpara aplikimit duhet të kryhen testime përshtatshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika ViscoBond® GR
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020301010010000246

SikaViscoBondGR-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

